

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 03.02.2023

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.01.2023, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 47, të datës 18.01.2023, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 8 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, (Gazeta Zyrtare Nr. 27/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (ç), nenin 54 të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për rritjen e të hyrave vetanake në buxhetin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2022


1. Për rritjen e të hyrave vetanake për vitin fiskal 2022 në buxhetin e Komunës së Fushë-Kosovës, në shumën e mjeteve financiare prej: 842,934.00€, të shpërndara nëpër kategoritë ekonomike buxhetore: mallra e shërbimeve, subvencione e transfereve dhe investime kapitale nëpër kodet buxhetore të programeve, nënprogrameve dhe projekteve si vijon:
 - 1.1 Mjetet financiare në shumë prej: 100,000.00€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike mallëra dhe shërbime - 13, në kodin e programit Administratën e Arsimit me numër 92010;
 - 1.2 Mjetet financiare në shumë prej: 441,047.30€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere - 20, në katër kode të programeve.
 - 1.2.1 Në Administratën e Shëndetësisë, programi 73011, shuma e mjeteve financiare prej: 150,000.00€;
 - 1.2.2 Në Kulturë Rini dhe Sport, programi 85002, shuma e mjeteve financiare prej: 150,000.00€
 - 1.2.3 Në Administratën e Arsimit, programi 92010, shuma e mjeteve financiare prej: 100,000.00€ dhe
 - 1.2.4 Në Infrastrukturë Publike, programi 18162, shuma e mjeteve financiare prej: 41,047.30€.
 - 1.3 Mjetet financiare në shumë prej: 301,886.70€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike investime kapitale - 30, në kodin e programit dhe kodin e projektit:
 - 1.3.1 Në Buxhet dhe Financa, programi 17502, për projektin 'Bashkëfinancim në Projekte', kodi ekonomik i projektit me numër 44684, shuma e mjeteve financiare prej: 201,886.70€;

- 1.3.2 Hapja e kodit të ri për 'Blerjen e pronës në lagjet 028 dhe 029 në lagjet e komuniteteve joshumicë në Komunën e Fushë-Kosovës' - hapet Kodi i ri ekonomik i projektit në shumën e mjeteve financiare prej: 100,000.00€.
2. Mjetet financiare në shumë të përgjithshme prej: 842,934.00€ nga paragrafi 1, të zbërthyer në nën paragrafin 1.1 - në kategorinë mallëra dhe shërbime në Administratën e Arsimit shpenzohen për mirëmbajtje dhe shërbime tjera për mbarëvajtje të procesit mësimorë, nënparagrafi 1.2 - në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere, nënparagrafi 1.2.1 në Administratën e Shëndetësisë shpenzohen për ndihma për trajtim shëndetësorë, nënparagrafi 1.2.2 në Kulturë Rini dhe Sport shpenzohen për përkrahje financiare të Organizatave Jo Qeveritare në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, nënparagrafi 1.2.3 në Administratën e Arsimit shpenzohen për ndihma për studentë, nënparagrafi 1.2.4 në Infrastrukturën Publike shpenzohen për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës dhe paragrafi 1.3, nënparagrafi 1.3.1 në kategorinë ekonomike të Investimeve Kapitale, në programin Buxhet dhe Financa, shpenzohen në kodin e projektit për 'Bashkëfinancim në projekte tjera publike' dhe nënparagrafi 1.3.2 shpenzohen për Kodin e ri ekonomik të projektit për 'Blerjen e pronës në lagjen 028 dhe 029 në lagjet e komuniteteve joshumicë në Komunën e Fushë-Kosovës.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së FB, Drejtorive tjera të Komunës dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Ali Ismaili**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 03.02.2023

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.01.2023, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 48, të datës 18.01.2023, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 8 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049, (Gazeta Zyrtare Nr. 27/2008), nenin 27 të Ligjit 03/L-048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (ç) dhe nenin 54 të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për lejimin e bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit fiskal 2022 në vitin fiskal 2023


1. Për lejimin e bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit fiskal 2022, në vitin fiskal 2023 në shumë të përgjithshme prej 6,354,114.03€, sipas propozimit dhe përshkrimit në dokumentin financiar të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit me Nr. 48, të datës 18.01.2023, me ndryshimet e propozuara në Kuvendin e Komunës për hapjen e kodit të ri në kapitale për 'Blerjen e pronës në lagjen 028 dhe 029 në lagjet e banuara nga komunitetet joshumicë në Komunën e Fushë-Kosovës, të prezantuara në formën tabelare - pjesë e këtij vendimi.
2. Bartja e mjeteve financiare nga të hyrave vetjake të pa shpenzuara është për kategoritë ekonomike të shpenzimeve si vijon:
 - 2.1 Për kategorinë ekonomike paga dhe shtesë shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 193,497.53€
 - 2.2 Për kategorinë ekonomike mallra e shërbime shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 745,485.20€;
 - 2.3 Për kategorinë ekonomike subvencione shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 543,180.44€;
 - 2.4 Për kategorinë ekonomike investime kapitale shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 4,871,950.86€.
3. Shpërndarja e mjeteve financiare të bartura sipas përshkrimit bazik në pikën një dhe dy të vendimit dhe hapja e kodit të ri sipas emërimit të tij në pikën një të vendimit, shpenzimet janë të detajizuara dhe të përshkruara, për secilin shpenzim në dokumentin financiar që është pjesë e këtij vendimi.

4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Financa dhe Buxhet.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.hh

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorive tjera të Komunës dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 06.02.2023

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.01.2023, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 270, të datës 13.12.2022, paraqitur nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës mbështetur në punën e grupit punues, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (ç) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç) dhe nenin 27, shkronja (ç) të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 9, të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës Nr. 62, të datës 16.05.2013 mori:

V E N D I M

Për miratimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2023

1. Për miratimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2023.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani Vjetor për Punën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2023.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorateve të Komunës dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Ali Ismaili



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKTOJA ZA ADMINISTRACIJEN

Nr./No. 25
Data/Datum 06.02.2023
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 06.02.2023

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 30.01.2023, pas shqyrtimit të Projekt-Rregullores për Organizimin e Punës në Shkollat Filllore të Mesme të Ulëta dhe Shkollat e Mesme të Larta në Komunën e Fushë-Kosovës, të hartuar nga Grupi Punues sipas vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 54, të datës 07.03.2022, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 17, shkronja (h), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 5, shkronja (i), të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, nenin 9, paragrafët 1 deri në 6 dhe 11, 12, të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit Nr. 03/2016 – këshilli Drejtues i Shkollës, dispozitat e Ligjit për Kundërvajtje Nr. 05/L-087, nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për miratimin e Rregullores për Organizimin e Punës në Shkollat Filllore të Mesme të Ulëta dhe Shkollat e Mesme të Larta në Komunën e Fushë-Kosovës

1. Për miratimin e Rregullores për Organizimin e Punës në Shkollat Filllore të Mesme të Ulëta dhe Shkollat e Mesme të Larta në Komunën e Fushë-Kosovës.
2. Rregullorja për Organizimin e Punës në Shkollat Filllore të Mesme të Ulëta dhe Shkollat e mesme të Larta në Komunën e Fushë-Kosovës, parasheh rregullimin e procesit edukativo-arsimorë, organizimin e punës në shkolla, disiplinën në shkolla dhe mirëmbajtjen e rregullt të ambientit të punës në objektet shkollore.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Rregullorja për Organizimin e Punës në Shkollat Filllore të Mesme të Ulëta dhe Shkollat e Mesme të Larta në Komunën e Fushë-Kosovës.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe rregullores për Organizimin e Punës në Shkollat Filllore të Mesme të Ulëta dhe Shkollat e Mesme të Larta në Komunën e Fushë-Kosovës, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Arsimit të Fushë-Kosovës.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së ARSIMIT dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr.faq/Bc.str. 27
Data/Calum. 06.02.2023
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE

Datë: 06.02.2023

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 30.01.2023, pas shqyrtimit të Projekt-Rregullores për Shërbime Publike në Komunën e Fushë-Kosovës, të hartuar nga Grupi Punues sipas vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 54, të datës 07.03.2022, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për miratimin e Rregullores për Shërbime Publike në Komunën e Fushë-Kosovës

1. Për miratimin e Rregullores për Shërbime Publike në Komunën e Fushë-Kosovës.
2. Rregullorja për Shërbime Publike në Komunën e Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e rregullimit dhe ofrimit të shërbimeve publike në territorin e komunës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Rregullorja për Shërbime Publike e Komunës së Fushë-Kosovës.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe rregullores për shërbime publike, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Shërbimeve Publike e Mjedisit dhe Drejtorisë së Inspektoratit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së SHPM, Drejtorisë së INSPK dhe Arkivës.**

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 06.02.2023

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 30.01.2023, pas shqyrtimit të Projekt-Rregullores për varreza, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, të hartuar nga Grupi Punues sipas vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 54, të datës 07.03.2022, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për miratimin e Rregullores për varreza, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës

1. Për miratimin e Rregullores për varreza, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Rregullorja për varreza, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e ofrimit të shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre në territorin e komunës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Rregullorja për varreza, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe rregullores për varreza, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre në territorin e komunës, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike e Mjedisit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së SHPM dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU

Nrfaq/Br. str. 31
Datë/Datum. 06. 02. 2023
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE

Datë: 06.02.2023

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 30.01.2023, pas shqyrtimit të Propozimit për shqyrtimin e parë të Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave, të hartuar nga Grupi Punues sipas vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 54, të datës 07.03.2022, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Fushë-Kosovës

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Projekt-Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e menaxhimit, ndarjen e mbeturinave në territorin e komunës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Rregullorja për menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe mbajtjen e diskutimit publikë, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike e Mjedisit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së SHPM dhe Arkivës.


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 06.02.2023

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 30.01.2023, pas shqyrtimit të Propozimit për shqyrtimin e parë të Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave, të hartuar nga Grupi Punues sipas vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 54, të datës 07.03.2022, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (ç), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave për vitet 2023-2027 në Komunën e Fushë-Kosovës

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave për vitet 2023-2027 në Komunën e Fushë-Kosovës.
2. Projekt-Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, i cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e menaxhimit të mbeturinave e për vitet 2023-2027 në Komunën Fushë-Kosovës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave për vitet 2023-2027 në Komunën e Fushë-Kosovës.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe mbajtjen e diskutimit publikë, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike e Mjedisit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së SHPM dhe Arkivës.


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 06.02.2023

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.01.2023, pas rishqyrtimit të vendimit Nr. 285, të datës 29.12.2022, sipas shkresës Nr. 04-1/2023, të datës 19.01.2023, të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve, i rishqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç) dhe nenin 27, shkronja (ç) të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për ndryshimin-plotësimin e vendimit Nr. 285, të datës 29.12.2022 për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për periudhën janar-mars 2023

1. Për rishqyrtimin dhe ndryshimin-plotësimin e pikës një të vendimit Nr. 285, të datës 29.12.2022, për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për banorët e Komunës së Fushë-Kosovës, me dokumentacion personal të identifikimit, për periudhën janar-mars 2023, nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve 20, programi 18162, me mundësi vazhdimi edhe për tre muaj, në shumën e mjeteve financiare prej: 245.00€, nga buxheti i komunës për çdo ceremoni të varrimit, përfshirë të gjitha komunitetet fetare.
2. Sigurimi i mjeteve financiare sipas pikës një të vendimit nga buxheti i komunës, për periudhën në fjalë, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Financave e Buxhetit.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit.
4. Për shpenzimin e mjeteve financiare të lejuara nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve 20, programi 18162, përfaqësuesit e Këshillit të Bashkësisë Islame të Fushë-Kosovës, Kishës Ortodokse dhe bashkësive tjera fetare, i raportojnë me shkrim Kuvendit të Komunës.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqën e komunës dhe shfuqizon, vendimin Nr. 285, të datës 29.12.2022

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së SHPM, Këshillit të Bashkësisë Islame në Fushë-Kosovë, Kishës Ortodokse Serbe në Fushë-Kosovë dhe Arkivës

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Ali Ismaili

